

Në bazë të nenit 3 paragrafit 1 alineja 20 dhe neni 13 nga Ligji për Qendrën Shtetërore të Provimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 и 64/18), nenet 12, 15 dhe 16 nga Rregullorja mbi mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimin e lartësisë së kompensimeve autoriale dhe kompensimeve për shërbime të tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr. 01-84/3 nga 28.1. 2021, drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve, solli vendim për:

KONKURS PUBLIK për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - vlerësues

Për shkak të realizimit me urgjencë dhe pa zvarritje të procesit të vlerësimit të materialit të provimit nga matura shtetërore në afatet e parapara Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore në vitin shkollor 2021/2022 si vijon, për lëndët:

- *Gjuhë maqedonase dhe letërsi;*
- *Gjuhë shqipe dhe letërsi;*
- *Gjuhë turke dhe letërsi;*
- *Gjuhë angleze;*
- *Gjuhë frënge;*
- *Gjuhë gjermane;*
- *Gjuhë ruse;*
- *Matematikë (për gjuhën mësimore maqedonase);*
- *Matematikë (për gjuhën mësimore shqipe);*
- *Matematikë (për gjuhën mësimore turke);*
- *Estetikë/Filozofi (për gjuhën mësimore maqedonase);*
- *Estetikë/Filozofi (për gjuhën mësimore shqipe);*

Vlerësimi i testeve do të bëhet në Shkup, në periudhën nga 08.6. 2022 deri më 28.6. 2022.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet vijuese:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të kenë arsim të lartë adekuat;
- të kenë së paku tre vite përvojë pune në arsim;
- të realizojnë mësimdhënie në shkollë të mesme në lëndën gjegjëse;

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet vijuese:

- fletëparaqitje të plotësuar;
- kopje të certifikatës/diplomës mbi arsimin e lartë adekuat;
- vërtetim mbi përvojën e punës në arsim nga lënda gjegjëse në shkollë të mesme, me vitet e stazhit të punës (jo më të vjetër se tre muaj);

Fletëparaqitja mund të shkarkohet nga ueb-faqja www.matura.gov.mk dhe dic.edu.mk

Fletëparaqitjet me dokumentacion të pakompletuar dhe jovalid, si dhe fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë nuk do jenë lëndë shqyrtimi.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e sipërpërmendura do ftohen në trajnim dhe do të testohen, pastaj do të pasojë përzgjedhja përfundimtare.

Kandidatët të cilët nuk marrin pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtejme.

Konkursi është i hapur deri **më 28.3. 2022.**

QENDRA SHETËRORE E PROVIMEVE